

VENDIM
Nr.519, datë 10.12.1992

**PËR ADMINISTRIMIN E BURSIVE TË STUDIMEVE UNIVERSITARE E
PASUNIVERSITARE DHE TË VEPRIMTARIVE TË TJERA KUALIFIKUESE JASHTË
SHTETIT**

Me propozimin Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Ministrisë së Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë ngarkohet me administrimin e bursave të studimeve universitare e pasuniversitare dhe të veprimtarive të tjera kualifikuese jashtë shtetit.

2. Burimet e këtyre bursave janë :

a) Bursa që i japin vendit tonë shtete, organizta ndërkombëtare, institucone të ndryshme, fondacione etj. Të tilla bursa janë ato që përmbahen në marrëvshjet ose programet periodike të nënshkruara në emër të qevertisë së Republikës së Shqipërisë me qeveritë e vendeve të tjera (marrëveshje kulturore, arsimore, tekniko-shkencore, ekonomike, shëndetësore etj.) dhe me organiztat ndërkombëtare, në dokumente të tjrra ku vendi ynë është palë, dhe njoftimet zyrtare që vijnë për qeverinë tonë. Kopje të këtyre dokumenteve i dërgohen Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë pas nënshkrimit ose njoftimit zyrtar.

b) Bursa që jep shteti ynë, miratimi i të cilave dhe i fondit përkatës bëhet cdo vit nga Këshilli i Minsitrave, në bazë të propozimit të Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë.

3. Për përdorimin e këtyre bursave, ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, brenda tremujorit të parë të cdo viti, propozojnë në Komitetin e Shkencës dhe të Teknologjisë fushat për vitin pasardhës, duke shënuar nënfushën e ngushtë, temën konkrete, kohëzgjatjen, shtetin dhe, kur është e mundur, edhe adresën e institucionit ku mendohet të kryhen studimet, specializimet e kualifikimet.

4. Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë, duke u bazuar në propozimet e ministrive e të institucioneve të tjera qendrore, në mundësitë që kanë palët e tjera për fushat e propozuara, si dhe në sasinë e bursave që disponohen, brenda muajit qershor të cdo viti, harton e miraton planin e vitit pasardhës të studimeve universitare e pasuniversitare dhe të kualifikimeve jashtë shtetit, të ndara sipas ministrive e institucioneve të tjera qendrore, duke përcaktuar njëkohësisht çdo fushë nënfushën e ngushtë, temën konkrete, kohëzgjatjen dhe shtetin përkatës. Ky plan, së bashku me kriteret e pranimit të kandidatëve, shpallet me mjetet e infpormacuionit e të shtypit për qëllime konkurimi.

Shpërndarja e bursave që ofrohen pas miratimit të planit nga Komiteti, miratohet nga kryetari i Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë.

5. Minnistritë dhe institucionet e tjera qendrore krijojnë mundësi të barabarta për gjithë shtetasit për konkurim të lirë, të cilët duhet të jenë të punësuar në sektorin shtetëror ose në atë privat.

Titullari i ministrisë ose institucionit tjetër qendror krijon çdo vit një komision të vecashtë për vlerësimin e kandidaturave që paraqitin kërkesën sipas kriterëve të caktuara. Komisioni, pasi studion dokumentacionin e secilit konkurrues, përzgjedh jo më pak se 4-5 kandidatë për cdo bursë dhe ministria ose institucioni tjetër qendror ia dërgon Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë brenda muajit nëntor të cdo viti. Në rastet kur kandidatet nuk i plotësojnë kriteret për të marrë bursë, Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë ua kthen propozimet mimistrive ose instiotucioneve të tjera qendrore për t'i zëvendësuar me të tjerë.

6. Kandidatëte miratuar më sipër i nënshtrohen testimit të gjuhës që kërkon shteti që ofron bursën. Kur një gjë e tillë nuk kërkohet nga shteti palë, testimi i gjuhës bëhet sipas kriterëve të përcaktuara nga pala jonë.

7. Deri në vitin 1994 të persekutuarit politikë që do të caktohen kandidatë për studime të plota universitare, përjashtohen nga testimi i gjuhës së huaj. Mësimi i gjuhës për këtë kategori do të bëhet gjatë vitit të parë të studimeve në shtetin përkatës.

8. Komiteti i shkencës dhe i teknologjisë krijon një komision të përbashkët me shtetin ose palën që jep bursa. Për palën shqiptare komisioni përbëhet nga përfaqësues të Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë, Ministrisë së Arsimit, Minsitrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, si dhe

Ministrisë së Punëve të Jashtme. Kryetari i Komisionit të përbashkët për palën shqiptare caktohet nga kryetari i Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë.

9. Komisioni i përbashkët, mbi bazën e dokumenteve të kandidatëve dhe testimit gjuhësor, përcakton kandidatët fitues, publikon emrat e tyre në mjetet e informacionit dhe në rrugë diplomatike i përcjell dokumentet e tyre në përfaqësitë e palëve që ofrojnë bursat.

10. Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë ndjek realizimin e bursave të planit që ai miraton, duke mbajtur lidhje të drejtpërdrejta me palët dhe me përfaqësitë tona jashtë shtetit. Për problemet që mund të dalin, bashkëpunon me Ministrinë e Punëve të Jashtme.

11. Shpenzimet e udhëtimit përballohen nga vetë kandidatët, kur në marrëveshjet me palët nuk parashikohet ndryshe. Në raste të veçanta këto shpenzime të përballohen nga qendrat e punës të kandidatëve ose nga ministritë a institucionet e tjera qendrore përkatëse.

12. Ndërmjet punëdhënësit dhe kandidatit që dërgohet jashtë shtetit për studime e kualifikime, nënshkruhet një kontratë me detyrimet e ndërsjella:

a) Punëdhënësi i ruan kandidatit vendin e punës dhe gjatë kohës së studimit i jep familjes së tij shpërblim në masën e caktuar me dispozita të veçanta.

b) Kandidati duhet të kthehet në vendin e tij të punës dhe të punojë të paktën 3-5 vjet për të vënë në jetë njohuritë e fituara. Në rast të kundërt detyrohet të kthejë shpenzimet e harxhuara për specializimin ose kualifikimin e tij.

13. Përdorimi i bursave që përmbahen në marrëveshje ose protokolle të nënshkruara nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, universitetet etj. me homologët e tyre në vende të tjera, si dhe i bursave që vijnë të adresuara nga burime të ndryshme, nga përdorimi i të cilave ministrisë, institucionit qendror, universitetit etj. u lindin detyrime, të kryhet sipas dispozitave të këtij vendimi, me të vetmin ndryshim që rolin e Komitetit të Shkencës dhe të Teknologjisë e kryejnë drejtuesit përkatës. Për përdorimin e këtyre bursave ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, universitetet etj. informojnë Komitetin e Shkencës dhe të Teknologjisë.

14. Komiteti i Shkencës dhe i Teknologjisë dhe Ministria e Arsimit hartojnë udhëzimet për procedurat dhe kriteret e zbatimit të planit për studimet universitare e pasuniversitare afatgjatë tre dhe për kualifikimet afatshkurtër.

15. Ministria e Punëve të Jashtme t'ua bëjë të njohur palëve të tjera përmbajtjen e këtij vendimi.

16. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.370, datë 21.11.1991 "Për administrimin e bursave të studimeve universitare, pasuniversitare dhe të veprimtaive të tjera kualifikuese jashtë shtetit", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi